



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ELBASAN**

RAPORTI VJETOR MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT

NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

PËR VITIN 2017

PASQYRA E LËNDËS

- I. Drejtimet dhe Përparësitë në Luftën kundër Kriminalitetit**
- II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë**
- III. Treguesit kryesorë të punës së Prokurorisë në dy vitet e fundit**
- IV. Të dhëna gjeografike dhe demografike**
- V. Shtrirja e kriminalitetit sipas territorit**
- VI. Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal**
- VII. Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë**
- VIII. Analiza e veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal**
- IX. Proçedimet penale në gjykim**
- X. Politika e Dënimit**
- XI. Çështje të hetimit**
- XII. Të dhënat për të pandehurit dhe të dëmtuarit**
- XIII. Pasojat e veprave penale**
- XIV. Kërkesat penale**
- XV. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja**
- XVI. Struktura organizative**
- XVII. Administrimi i teknologjisë dhe informacionit në Prokurori**
- XVIII. Raporti financiar**
- XIX. Çështje të tjera me rëndësi**
- XX. Në vend të mbylljes**

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, parashtron në këtë raport, funksionimin e saj sipas Kushtetutës dhe ligjeve, në ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si dhe funksione të tjera të ngarkuara me ligje të posaçme.

Viti 2017, ka qenë një vit ndryshimesh, si përsa i përket legjislacionit penal, procedural penal ashtu edhe ligjit organik. Ndryshimet, në kuadrin e Reformës për Drejtësi, kanë prekur edhe vetë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Në ushtrimin e funksioneve të saj, prokurorët e kësaj prokurorie si dhe oficerët e policisë gjyqësore, janë munduar të absorbojnë në mënyrën sa më të shpejtë dhe efikase, ndryshimet e pësuar në legjislacion dhe ndryshimet organike, me qëllim, respektimin e Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjeve në fuqi, respektimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale, etikën, disiplinën në punë, të drejtat e njeriut, duke i vënë vetes përparësi dhe objektiva, duke u angazhuar në kryerjen me sa më efikasitet të funksioneve të saj.

Prokurorët e kësaj prokurorie, në përsosjen e njohurive dhe dijeve të tyre, janë treguar vazhdimisht të angazhuar me pjesëmarrjen e tyre në Programin e Trajnimit Vazhdues, program ky i mundësuar nga Shkolla e Magjistraturës. Do të dëshironim që edhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve, t'u ofroreshin po të njëjtat mundësi trajnimi, duke e parë si një domosdoshmëri për efikasitetin në hetim.

1.1. Lufta kundër Korrupsionit dhe krimit ekonomik

Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave ka qenë prioritet në ushtrimin e funksioneve, përgjatë vitit 2017. Rol të posaçëm në këtë drejtim ka pasur Njësia e Përbashkët Hetimore e cila me ndryshimet e reja, u strukturua në formën e një Seksioni me emërtimin: Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër Korrupsionit, shpërdorimit të detyrës dhe pastrimit të produkteve të veprave penale ose veprimtarisë kriminale.

Volumi në hetim, ka qenë thujtë i njëjtë me atë të një viti të kaluar. Vërehet se janë rritur mosfillimet e procedimeve penale, duke u ulur numri i rregjistrimit të procedimeve penale. Kanë përfunduar 80% e çështjeve duke u mbetur ende në hetim dhe verifikim 20 % nga ngarkesa totale që kanë pasur prokurorët përgjatë vitit 2017. Në vitin 2016, konstatohet se ka pasur një numër më të madh çështjesh të përfunduara. Diferenca me vitin 2017, është prej një shifër prej 3 %. Në këtë aspekt, duhet theksuar se kanë ndikuar krijimi i seksioneve, zëvendësimi apo mbartja e tyre nga njëri seksion tek tjetri dhe natyrisht edhe ndryshimet e reja ligjore, ku prokurori për vendimmarrjet që kanë të bëjnë me pushimin duhet t'i adresohet gjykatës.

Këtë vit, ka pasur një rritje të ndjeshme të veprave penale kundër korrupsionit, fakt i cili bashkëshoqërohet edhe me një rritje të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim dhe të pandehurve të akuzuar e dërguar në gjykim për këtë aktivitet kriminal. Sërish nga ana jonë, ekziston angazhimi, që kryesisht të marrim dijeni për këto lloj veprash penale dhe të mundësojmë një bashkëpunim më të frytshëm me aktorët e tjerë, institucione apo ndërgjegjësimin e qytetarëve për denoncimin e rasteve.

Ka pasur një rritje të lehtë në drejtim të nurmit të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe janë dërguar për gjykim 3 procedime penale me 6 të pandehur. Pra, vërehet një diferencë e lehtë në rritje në këtë drejtim. Natyrisht duke vendosur para vetes angazhimin maksimal për zbulimin dhe hetimin e këtyre veprave penale, kërkojmë një bashkëpunim nga organet e tjera ligjzbatuese që të na mbështesin në zbulimin e këtyre veprave penale. Rol të veçantë ka luajtur natyrshëm SHISH apo DPPP por angazhim më të madh kërkohet edhe nga institucione të tjera siç janë organet tatimore apo doganore.

1.2. Lufta kundër lëndëve narkotike

Treguesit në lidhje me veprat penale, që lidhen me faktet e kundraligjshme që si objekt material kanë lëndët narkotike kanë pësuar një rënie të lehtë, jo në rregjistrimin e çështjeve por në dërgimin e tyre për gjykim. Kjo shpesh ka të bëjë me faktin se referohen përdoruesit e lëndës narkotike dhe ende nuk ekziston një përqëndrim më i madh nga policia gjyqësore, për evidentimin në një shkallë më të gjerë të personave janë të angazhuar me prodhimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Përsa i përket kultivimit të lëndë snarkotike, konstatohet se ky tregues ka pësuar rënie.

1.3. Prioritete të tjera

Fakt problematik vazhdojnë të mbeten konfliktet e pronësisë, që çojnë në kryerjen e veprave penale të falsifikimit apo të shpërdorimit të detyrës nga funksionarët përkatës.

Shkatërrimi i pronës apo vjedhjet vazhdojnë të kenë një peshë të madhe në raportin e përgjithshëm të veprave penale të ndodhura në këtë qark.

Lufta kundër këtyre veprave penale, nuk mund të zhvillohet e vetme, pasi ndikojnë kryesisht faktorët socialë, në rastin e vjedhjes së pasurisë.

Megjithatë angazhimi nga ana jonë ka qenë maksimal për të vënë në një kohë sa më të shkurtër, para drejtësisë, personat përgjegjës.

Jemi angazhuar maksimalisht për të mundësuar gjykimet e drejtëpërdrejta, me qëllim kufizimin e shpenzimeve proceduriale dhe dhënien e drejtësisë në një kohë sa më të shkurtër.

1.4. Të drejtat e njeriut

Në ushtrimin e funksioneve, kemi mbajtur parasysh respektimin e të drejtave të njeriut, qoftë të viktimave, familjarëve të tyre ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve, të paraburgosurve apo të dënuarve. Ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale, sollën për viktimat e veprave penale, të drejta për një pjesmarrje më të madhe në procedim, gjë e cila është reflektuar në punën e kryer.

Është bërë i mundshëm aksesimi në prokurori nëpërmjet dhënies së informacionit, në respektim të së drejtës së informimit dhe duke i mundësuar palëve të drejta të barabarta gjatë hetimit, por gjithmonë duke vlerësuar rast pas rasti edhe sekretin hetimor.

Përparësi e veçantë i është dhënë të miturve, qoftë të dëmtuar apo viktime, duke pasur parasysh edhe specializimin e prokurorëve që kanë qenë pjesë e Seksionit të hetimit dhe pjesëmarrjes në gjykim, për veprat penale të kryera nga të miturit dhe ndaj të miturve.

1.5. Bashkëpunimi ndërinstytucional

Pasur parasysh mënyrën se si iniciohen hetimet, vijueshmërinë e tyre, një rol të veçantë në përmbushjen e funksioneve tona, e ka policia gjyqësore e shërbimeve. Qarku i Elbasanit, me një shtrirje të madhe gjeografike, ka konstatuar angazhimin e policisë gjyqësore për zbulimin e veprave penale dhe raportimin e tyre, megjithëse për shkak të funksionimit të policisë gjyqësore, kemi hasur pengesa në përfundimin në një kohë sa më të shpejtë të hetimit. Policia gjyqësore është fakt që angazhohet edhe me kryerje detyrash të tjera përveç hetimit, gjë që çon drejt mbingarkesës së policisë gjyqësore të seksioneve dhe ngadalësimin në hetime.

Kemi pritshmëri për një angazhim maksimal edhe nga organe të tjera për njoftimin e fakteve penale për të cilat vihen në dijeni, kryesisht organet tatimore dhe doganore, të cilat në shumë raste tregohen apatike. Funksionin e tyre, përpiqet ta marrë shpesh herë përsipër policia e shtetit por ky fakt krijon shpesh pengesa proceduriale, dhe rritje fiktive të regjistrimeve të materiale në prokurori, pasi nuk ezaurohen hallkat administrative, sipas ligjeve përkatëse që rregullojnë këto fusha specifike.

Në lidhje me institucionet e tjera si Gjykatën, Ministrinë e Drejtësisë etj, bashkëpunimi ka qenë i frytshëm dhe korrekt.

1.6. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Pasur parasysh lirinë e lëvizjes është tashmë një fakt i njohur që provat apo të dhënat mbi veprat penale mund të gjenden në shtete të ndryshme. Për këtë shkak ka ekzistuar një bashkëpunim i mirë me shtetet e huaja si në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike të dërguara prej tyre, pranë institucionit tonë ashtu edhe të letër porosive të përcjella prej nesh, apo transferimit të procedimeve penale.


Rol të veçantë i është kushtuar ekstradimeve, urdhërave të kërkimit ndërkombëtar, duke marrë të gjitha masat e duhura për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe parimin e reciprocitetit.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË

Volumi i punës në hetim për vitin 2017

Përgjatë vitit 2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka punuar me **4 221 materiale**.

- Procedime penale, janë **3 002** materiale
- Materiale kallzuese janë **1 219** materiale.



Ndërkohë përgjatë vitit 2016, kjo prokurori ka punuar me **4284 materiale**.


- Procedime penale, janë 3229 materiale
- Materiale kallzuese 1055



Krahasimi ndërmjet dy viteve, ngarkesa e kësaj prokurorie, për tërësinë e materialeve të trajtuara, megjithëse në shifra, tregon për një rënie prej 63 materialesh, në vitin 2017, në përqindje, rezulton të jetë i njëjtë:




Procedimet penale, në raport të dy viteve, tregojnë për një rënie me 4% të procedimeve penale në vitin 2017.



Në fakt, nga viti 2015 për në vitin 2016, kishim një numër më të madh materialesh të mbartura se sa nga viti 2016 për në vitin 2017. Koncretisht në vitin 2016 kishim mbartur 909 procedime, hetimi i të cilave vazhdoi përgjatë këtij viti, kurse në vitin 2017, kishim mbartur 697 procedime penale.

Materialet kallzuese, në raport të dy viteve, tregojnë për një rritje prej 8% të kallzimeve penale në vitin 2017.



Raporti i çështjeve të reja me të mbarturat dhe prurjet e tjera:

Nga numri i tërësisë së materialeve penale, evidentohet se:


- 697 procedime penale kanë qenë të mbartura nga viti i kaluar;
- 2271 janë rregjistruar procedime penale të reja;
- 21 janë rifilluar;
- 13 kanë ardhur në Prokurorinë tonë për shkak të kompetencës.
- Ndërkohë rezulton se janë mosfilluar 1137 materiale;
- Janë ende në verifikim 79 materiale kallzuese;
- Janë përcjellë për kompetencë 3 materiale kallzuese.

Në numrin e materialeve kallzuese për të cilat është vendosur mosfillimi, 314 materiale, nuk kanë pasur të përcaktuar një vepër penale. Kjo ndodh zakonisht kur materialet përcillen për

vlerësim, për shkak të ngjarjeve të pakualifikuara në kuadrin e ndonjë vepre penale siç mund të jenë vdekjet natyrore etj.


Pra në përqindje rezulton se nga tërësia e materialeve 71 % përbëjnë procedime penale, 27 % materiale kallzuese të mosfilluara dhe 2 % janë materiale kallzuese ende në verifikim.

Në përqindje raporti i çështjeve është si vijon:



Puna e kryer në total:


Kjo prokurori ka përfunduar hetimet për 3366 materiale, ndërkohë që i kanë mbetur në hetim 776 procedime penale dhe 79 materiale kallzuese në verifikim.



Raporti i përfundimit të çështjeve dhe atyre të ngelura në hetim:


Rezulton të jenë përfunduar 1137 materiale kallzuese me vendim mosfillimi, 3 materiale kallzuese përcjellë për kompetencë, përfunduar 2226 procedime penale. Kanë ngelur në hetim 776 procedime penale dhe 79 materiale kallzuese në verifikim.

Pra në përqindje rezulton se nga tërësia e materialeve të përfunduara, 53% janë procedime penale, 27 % materiale kallzuese me vendim mosfillimi dhe kanë ngelur në hetim 18 % procedime penale e për verifikim 2% materiale kallzuese.




Llojet e vendimmarrjeve:

Për vitin 2017, është vendosur mosfillimi për 1137 çështje penale, janë përcjellë për kompetencë 3 materiale kallëzuese, janë pushuar 639 çështje penale, pezulluar 792 çështje, transferuar 29 çështje dhe dërguar për gjykim 766 çështje. Në përqindje ky raport shprehet në këtë mënyrë:




Për vitin 2016, është vendosur mosfillimi për 1021 çështje penale, janë pushuar 678 çështje penale, pezulluar 986 çështje, transferuar 28 çështje dhe dërguar për gjykim 844 çështje. Në përqindje ky raport shprehet në këtë mënyrë:




Krahasimi me vitin 2016:

Për vitin 2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka punuar me një numër çështjesh në total, prej 4284 materialesh (duke përjashtuar rifillimet e procedimeve për të cilat është vendosur pushimi për shkak parashkrimi), ndërkohë që në vitin 2017, siç theksuam materialet me të cilat janë punuar është një shifër prej 4221 çështjesh. Pra për vitin 2017 vihet re **një rënie e numrit të materialeve prej 63 çështjesh.**


Procedime penale me të cilat është punuar në vitin 2016 në këtë prokurori ka qenë 3229 në krahasim me vitin 2017 që është 3002 dhe materiale kallzuese për vitin 2016 kanë qenë 1055 ndërkohë që në vitin 2017 janë 1219.



Në vitin 2016 siç u theksua më sipër **kanë përfunduar 3557 materiale** ndërkohë që në vitin 2017 kanë përfunduar **3366 materiale**. Nga viti 2016 kishin ngelur në hetim 693 procedime penale dhe 34 materiale kallzuese në verifikim kurse për vitin 2017 kanë ngelur në hetim 776 procedime penale dhe 79 materiale verifikuese.





Raporti i çështjeve të përfunduara në vitet 2017 dhe 2016



Në përqindje raporti i çështjeve të përfunduara për vitet 2017 dhe 2016 është ky:

Pasur parasysh volumin e punës, konstatohet se në vitin 2017 janë përfunduar 3% më pak çështje penale, duke mbetur në hetim 3 % më shumë materiale.



Çështje të përfaqësuara në Gjykatë

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka përfaqësuar në gjykim, për vitin 2017, 988 çështje, nga të cilat 222 kanë qenë çështje të mbartura në gjykim nga viti 2016 kurse 766 çështje janë dërguar për gjykim në vitin 2017. Gjithsej në gjykim kanë qenë 1151 të pandehur, nga të cilët 352 të arrestuar.

Sa më lart, janë tregues vetëm për çështjet ku prokurori përfaqëson akuzën, duke mos përmendur çështjet në të cilat prokurori ka marrë pjesë në gjykim, me të dëmtuar akuzes apo raste të tjera si heqje zotësie për të vepruar etj.

Të shprehura në përqindje çështjet e dërguara për gjykim dhe të mbarturat në gjykim nga viti i kaluar, janë si vijon:



Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka përfaqësuar në gjykim, për vitin 2016, 1140 çështje, nga të cilat 296 kanë qenë çështje të mbartura në gjykim nga viti 2015 kurse 844 çështje janë dërguar për gjykim në vitin 2016, me 987 te pandehur, nga te cilet 331 te arrestuar.



Referuar raportit të çështjeve të përfaqësuara në gjykim, dy viteve të fundit, pra 2016 dhe 2017, rezulton se:





Pra në përqindje konstatohet se në vitin 2017, kjo prokurori **ka përfaqësuar në gjykim, 8 % më pak çështje se sa në vitin e kaluar.**


Çështje të dërguara në gjykim referuar numrit total të procedimeve të hetuara:

Pasur parasysh numrin total të **procedimeve penale të hetuara** në prokurori **përgjatë vitit 2017**, që është 3002 çështje, rezulton se janë dërguar për gjykim 766 çështje, me 871 të pandehur nga të cilët 287 kanë qenë të arrestuar.

Duke iu referuar **procedimeve penale që janë hetuar**, në vitin 2017 dhe 2016 konstatohet ky raport i dërgimit të çështjeve për gjykim:



Përqindja e çështjeve të dërguara për gjykim në krahasim të viteve 2016 dhe 2017:




Pra, kemi një rënie prej 4 % të procedimeve të dërguara në gjykim në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, ndërkohë që në raport me numrin total të çështjeve, konstatohet se në vitin 2017 janë dërguar për gjykim, 1% më shumë se vitin e kaluar.


Numri i të pandehurve të dërguar për gjykim në vitin 2017 ka qenë 871, nga të cilët 287 të arrestuar, ndërkohë që në vitin 2016 vihet re se ka qenë një numër më i lartë, pasi ky numër është 987, nga të cilët 331 të arrestuar. Konkretisht janë dërguar për gjykim 116 më pak të pandehur, për gjykim.

Numri në total i të pandehurve dhe personave nën hetim për vitin 2017 është 1240, nga të cilët janë dërguar për gjykim 871.


Në përqindje rezulton se 70 % e të pandehurve/personave nën hetim janë dërguar për gjykim:



Ndërkohë në vitin 2016, është konstatuar se numri total i të pandehurve dhe personave nën hetim, të regjistruar, ka qenë 1 399 nga të cilët 987 janë dërguar për gjykim.



Referuar numrit te te pandehurve te rregjistruar dhe personave nen hetim, ne dy vite konstatohet se jane derguar per gjykim ne vitin 2016, 6% me pak të pandehur, ne krahasim me vitin 2016.



Masat e sigurimit

Në gjykatë janë paraqitur, përgjatë vitit 2017, gjithsej 424 kërkesa për caktim mase sigurimi shtrënguese dhe 1 kërkesë për masë ndaluese. Gjykatat për vitin 2017 kanë vendosur të japin 423 masa shtrënguese dhe 1 masë ndaluese.

Ndërkohë gjatë vitit 2016, janë paraqitur në gjykatë, gjithsej 502 kërkesa për caktim të masave të sigurimit personal dhe 3 kërkesa për masa ndaluese. Gjykatat për vitin 2016 kanë vendosur të japin 501 masa shtrënguese dhe 3 masa ndaluese.

Pra ka një rënie prej 8% të kërkesave të prokurorit për caktimin e masave shtrënguese, në vitin 2017. I njëjti raport qëndron edhe me gjykatën.



Zbatimi i parashikimeve të reja ligjore:

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të reja proceduriale penale, rezulton se puna e prokurorëve, tashmë ndërthurret më shumë me atë të gjykatës. Prokurori nuk mund të vendosë më vetë pushimin e çështjeve por duhet t'i paraqesë kërkesë gjykatës.

Rezulton se janë paraqitur kërkesa në gjykatë për pushimin e çështjes, gjithsej 106, në të cilat ka pasur 21 persona nën hetim.

Gjykata ka dhënë deri tani 44 vendime për pushim çështje.

Gjithashtu rezulton se në gjykatë janë dërguar 21 çështje për miratim urdhëri penal, me 22 të pandehur. Gjykata ka vendosur miratimin për 11 prej tyre.

Në gjykatë janë dërguar 12 çështje për miratim marrëveshje, me 12 të pandehur dhe gjykata ka pranuar 8 kërkesa të tilla.


Janë dërguar me kërkesë për gjykim në seancë paraprake 244 çështje, me 271 të pandehur, dhe deri tani raportohet kërkesa për gjykim, për 57 çështje.

Numri në total i çështjeve për të cilat është paraqitur kërkesë për pushim, miratim urdhëri penal, kërkesë për gjykim apo me marrëveshje, janë përfshirë në tërësi si pushime, gjykime, në këtë raport, për shkak të zbatimit të ligjit në gjysmën e dytë të vitit 2017.

III. TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË DY VITET E FUNDIT


Procedime të rregjistruara

Procedime të rregjistruara për vitin 2017 janë gjithsej 2271 procedime penale ndërkohë që në vitin 2016 janë 2293 procedime. **Pra vihet re një tendencë shumë e ulët, në rënie e rregjistrimeve të procedimeve penale, me një shifër prej 22 procedime penale.**



Procedime në ndjekje

Në vitin 2016 mbartëm për vitin në vijim 693 procedime, ndërkohë që në përfundim të vitit 2017 mbartëm 776. Kjo tregon se kemi mbartur 83 procedime penale më shumë. Ky është një tregues negativ për punën e kryer. **Kemi lënë për ndjekje për vitin 2018, një shifër prej 6% procedime penale më shumë se viti i kaluar.**



Rezultojnë gjithsej 776 procedime penale në ndjekje, me 178 persona nën hetim, 46 të arrestuar.


- Veprat penale që kanë të bëjnë me *vjedhjen e pasurisë*, n. 134 – 142 të K.Penal, janë gjithsej **176 çështje penale**, me 17 persona nën hetim, 4 të arrestuar;

- Veprat penale *kundër rendit dhe sigurisë publike*, n. 261 – 299 të K.Penal, janë **gjithsej 163 çështje**, me 73 persona nën hetim, 25 të arrestuar;
- Vepra penale që *cënojnë regjimin juridik të tokës*, n. 199 – 200 të K.Penal, janë gjithsej **89 çështje**, me 2 persona nën hetim;
- Veprat penale *kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërore ose në shërbim publik*, n. 248 – 260 të K.Penal, janë gjithsej **60 çështje penale**, me 11 persona nën hetim;
- Vepra penale *kundër drejtësisë* n. 300 – 324 të K.Penal, janë gjithsej **55 çështje penale**, me 18 persona nën hetim, 1 të arrestuar;
- Veprat penale të *shkatërrimit të pronës*, n. 150 – 162 të K.Penal, janë gjithsej **44 çështje penale**, me 1 persona nën hetim;
- Vepra penale të *falsifikimit të dokumentave*, n. 186 – 192/b të K.Penal, janë gjithsej **42 çështje penale**, me 3 persona nën hetim;
- Vepra penale *kundër fëmijëve, martesës dhe familjes*, n. 124 – 130/a të K.Penal, janë gjithsej **27 çështje**, me 13 persona nën hetim, 5 të arrestuar. 23 çështje penale janë për dhunën në familje.
- Vepra penale me *dashje kundër shëndetit*, n. 86 – 90 i K.Penal, janë gjithsej **15 çështje**, me 10 persona nën hetim. Theksohet se 14 janë për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje.
- Vepra penale *që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës*, n. 93 – 99 të K.Penal, janë gjithsej **15 çështje**, me 3 persona nën hetim;
- Veprat penale të *mashtimit* janë gjithsej **13 çështje penale**, me 4 person nën hetim;
- Vepra penale *kundër mjedisit*, n. 201 – 207 të K.Penal, janë gjithsej **13 çështje penale**;
- Vepra penale *kundër jetës të kryera me dashje*, n. 76 – 84/a të K.Penal, janë gjithsej **12 çështje penale**, me 5 persona nën hetim, 4 të arrestuar. Theksohet se 6 janë për veprën penale të kanosjes dhe 6 për vepra penale të vrasjes;
- Vepra penale *kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit*, n. 235 – 247 të K.penal, janë gjithsej **11 çështje penale**, me 5 persona nën hetim, 1 të arrestuar;
- Veprat penale *në lidhje me taksat dhe tatimet* janë gjithsej **11 çështje penale**, me 1 person nën hetim;


- Vepra penale në lidhje me *falsifikimin e monedhave* janë gjithsej **8 çështje penale**, 6 persona nën hetim, 5 të arrestuar;
- Vepra penale *në lidhje me lojërat e fatit*, n. 197 – 198 i K.Penal janë gjithsej **7 çështje penale**, me 1 persona nën hetim;
- Vepra penale *kundër moralit dhe dinjitetit*, n. 113 – 123 të K.Penal, janë gjithsej **5 çështje penale**, me 1 person nën hetim, 1 të arrestuar;
- *Krime seksuale*, n. 100 – 108/a i K.Penal, janë gjithsej **3 çështje**, me 2 persona nën hetim;
- Vepra penale në *fushën e doganave*, n. 171 – 179/ç të K.Penal, janë gjithsej **3 çështje penale**, me 1 person nën hetim;
- Vepra penale që *prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*, janë gjithsej **3 çështje penale**, me 1 person nën hetim;
- Veprat penale *në shoqëritë tregtare*, është gjithsej **1 çështje penale**.

Krahasimi në përqindje i veprave penale të mbetura në hetim ndërmjet dy viteve:

Viti 2017




Viti 2016



Pra në vitin 2017, nga procedimet që kanë ngelur në hetim, pjesën më të madhe e zenë ato që janë rregjistruar për veprën penale të vjedhjes, njësoj si në vitin 2016.


Cështje të përfunduara

Në lidhje me **proçedimet e përfunduara** për vitin 2017 kanë qenë 2226 proçedime penale, ndërkohë që për vitin 2016 janë përfunduar 2536 proçedime penale. Pra në vitin 2017, janë përfunduar **6% çështje më pak** se viti i kaluar ose **310 proçedime penale më pak**.




Pushimet:

Në lidhje me **çështjet e pushuara** konstatohet se për vitin 2017 janë pushuar 639 çështje, me 180 persona nën hetim dhe 5 të arrestuar, ndërkohë që në vitin 2016 janë pushuar 678 çështje, me 228 persona nën hetim dhe 7 të arrestuar. **Pra ka një rënie të numrit të pushimeve të çështjeve me 39 proçedime penale ose me 2 %**.




Në vijim paraqesim në mënyrë grafike të dhënat në lidhje me veprat penale mbizotëruese për të cilat janë marrë më shumë vendime pushimi:

Viti 2017




Viti 2016:



Në çështjet e pushuara, ka pasur 180 persona nën hetim nga të cilët 5 kanë qenë të arrestuar. Konkretisht personat e arrestuar kanë qenë 2 për veprën penale të vrasjes me dashje mbetur në tentativë, 1 për vjedhje me dhunë dhe 2 për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.

Çështjet penale janë pushuar në 605 raste për shkaqe të tjera, në 27 raste për mungesë prove dhe në 7 raste për mungesë fakti.

Në mënyrë grafike paraqiten si vijon:




Pezullimet


Në lidhje me **çështjet e pezulluara** konstatohet se për vitin 2017 janë pezulluar 792 proçedime penale, ndërkohë që vitin 2016 janë pezulluar 986 proçedime penale. Pra numri rezulton në rënie për vitin 2017, me një numër procedimesh prej 194 më pak të pezulluara se vitin e kaluar.

Në lidhje me çështjet e pezulluara, rezulton se numri i tyre në vitin 2017 është 792 kurse në vitin 2016 ka qenë 986 çështje.

Për vitin 2016, procedimet penale të pezulluara, paraqiten grafikisht si më poshtë.



Veprat penale dominuese në vendimet e pezullimit në vitin 2017 janë si më poshtë:




Transferimet:

Për vitin 2017 rezulton të jenë transferuar 29 procedime penale, me 11 persona nën hetim, 4 të arrestuar.

Disponimi në total:

Në mënyrë grafike paraqesim procedimet penale në total dhe disponimi për to, në krahasim me dy vitet.




Personat nën hetim:


Persona nën hetim për vitin 2017 kanë qenë 369 kurse të pandehur kanë qenë 871. Në total numri i personave nën hetim dhe të pandehurve për vitin 2017 është 1 240.

Persona nën hetim për vitin 2016 kanë qenë 412 kurse të pandehur kanë qenë 987. Në total numri i personave nën hetim dhe të pandehurve për vitin 2016 është 1 399.


Pra në total vërehet se numri i personave nën hetim dhe të të pandehurve për vitin 2017 ka pësuar një rënie prej 159, ose 6 % më pak.




Më poshtë paraqesim të dhënat për personat nën hetim dhe të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të çështjeve dhe vazhdimet të ndjekjes penale.



Duke pasur parasysh numrin total të personave nën hetim dhe të të pandehurve të rregjistruar për vitin 2017 dhe 2016, paraqesim në mënyrë grafike personat për të cilët është përfunduar hetimi dhe ata për të cilët vazhdojnë hetimet.



Ne vitin 2017 kanë përfunduar hetimet për 1% persona nën hetim dhe të pandehur më pak se në vitin 2016.



Vendimmarrja e Gjykatës



Për vitin 2017, kanë qenë në gjykim gjithsej 988 çështje, me 1151 të pandehur. Nga ana e Gjykatës është vendosur për 106 të pandehur pushimi, 5 kthim aktesh dhe për 22 të pandehur është vendosur pafajësi. Pra janë dënuar 739 të pandehur dhe kanë mbetur në gjykim 279 të pandehur.

Për vitin 2016, kanë qenë në gjykim 1140 çështje, me 1369 të pandehur. Nga ana e Gjykatës është vendosur pushimi për 31 të pandehur, kthim aktesh për 8 të pandehur, dhe është vendosur pafajësi për 9 të pandehur. Pra janë dënuar 1069 të pandehur.

Për vitin 2016 janë dërguar në gjykim 844 çështje. Ndërkohë në vitin 2017 u dërguan për gjykim 766 çështje.

Pafajësi në vitin 2016 është dhënë në 9 raste ndërkohë që në vitin 2017 është dhënë në 22 raste.

Raporti në përqindje mes të pandehurve të dënuar dhe pushimet e gjyqimit dhe pafajësisë në përqindje, shprehen si më poshtë:




Mosfillimet


Për vitin 2016 janë mosfilluar gjithsej 1021 çështje, nga të cilat 216 kanë qenë të pakualifikuara në referim për ndonjë vepër penale.

Ndërkohë në vitin 2017, janë mosfilluar 1137 çështje, nga të cilat 314 kanë qenë të pakualifikuara në referim për ndonjë vepër penale.


Në mënyrë grafike paraqiten si vijon:



Veprat penale dominuese për të cilat është vendosur mosfillimi për vitin 2016 paraqiten si më poshtë:



Veprat penale dominuese për të cilat është vendosur mosfillimi në vitin 2017, paraqiten si më poshtë:



Cështje të transferuara


Janë kaluar për kompetencë në prokuroritë e rretheve të tjera gjyqësore gjithsej 29 çështje penale me 11 persona nën hetim, 4 të arrestuar.

IV. TE DHENA GJEOGRAFIKE DHE DEMOGRAFIKE


Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e shtrin kompetencen e vet ne nje hapësirë gjeografike dhe demografike te madhe. Njohja me këto të dhëna, duke e ndërthurrur me faktorë të tjerë, çon në kuptimin e rezultateve të punës sonë dhe të faktit përse disa vepra penale vihen re të kenë epërsi mbi disa të tjera.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e shtrin funksionin e vet në qarkun e Elbasanit.

Harta e qarkut Elbasan



Aktualisht, bazuar ne ligjin nr. 115 të vitit 2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Qarku Elbasan, ka si qendër të tij, qytetin e Elbasanit¹.




¹ Fillimisht rregullimet për qarkun janë bërë në bazë të ligjit nr. 8653 datë 31.07.2000 “Për ndarjen administrative territorial të njësive të qeverisjes vendore në R.Shqipërisë”, i shfuqizuar.

Ky qark përmbledh 7 bashki dhe 50 njësi administrative:

Numri i popullsisë në total është 441 229 banorë. Kurse si numër familjesh janë 129 664. Sipas Bashkive dhe njësite administrative që ato përmbledhin numri i popullsisë ndahet në këtë mënyrë (renditen sipas numrit më të madh):

1. Bashkia Elbasan – numri i banorëve 208 480 kurse numri i familjeve 63 001;
2. Bashkia Cërrik – numri i banorëve 47 118 kurse numri i familjeve 13 531;
3. Bashkia Librazhd – numri i banorëve 44 219 kurse numri i familjeve 12 647;
4. Bashkia Peqin – numri i banorëve 39 257 kurse numri i familjeve 10 979;
5. Bashkia Gramsh – numri i banorëve 36 077 kurse numri i familjeve 10 988;
6. Bashkia Prrenjas – numri i banorëve 33 250 kurse numri i familjeve 9 298;
7. Bashkia Belsh – numri i banorëve 32 828 kurse numri i familjeve 9 220;

Në mënyrë grafike, përqëndrimi i popullsisë paraqitet në këtë mënyrë²:




Pra, konstatohet se Bashkia Elbasan ka numrin më të madh të popullsisë, me 47 % të numrit total.

² Ofruar të dhënat nga Prefektura e Elbasanit


V. SHTRIRJA E KRIMINALITETIT SIPAS TERRITORIT

Më poshtë pasqyrohet në përqindje referimet e kryera dhe ngjarjet e ndodhura, pasur si burim, Drejtorinë e Policisë Vendore dhe Komisariatet përkatëse.

Viti 2017:




Viti 2016:




Sipas veprave penale të ndodhura, referimet e policisë gjyqësore, sipas shtrirjes territoriale konstatohet se janë referuar në këtë raport nga forcat policore:

Viti 2017:



Viti 2016:



Të dhënat në lidhje me njoftimet për veprat penale

Në vitin 2017 ka pasur 2276 referime dhe kallzime penale, kundrejt vitit 2016 që ka pasur 2262 kallzime dhe referime. **Pra vërehet një rritje e referimeve dhe kallzimeve në një shifër prej 14 materialesh, por që në përqindje nuk ka tregues.**



Kallzime nga policia e shtetit ka pasur 1243 në vitin 2017 kurse në vitin 2016 ka pasur 1254 në vitin 2016, shifër e cila është 11 referime më pak, por e cila nuk reflektohet në përqindjen totale.

Në vitin 2017 ka pasur 765 ngjarje kurse në vitin 2016 ka pasur 763 ngjarje, ose **2 ngjarje më shumë;**

Në vitin 2017 ka pasur 61 kallzime penale nga shtetasit, kurse në vitin 2016 ka pasur 154 kallzime nga shtetasit ose **44 % më pak.**




Në vitin 2017 ka pasur 207 kallëzime nga nëpunësit publikë ndërkohë që në vitin 2016 ka pasur 91 kallëzime nga nëpunësit publikë, ose **38% më shumë**.




Në vitin 2017 ashtu si edhe në vitin 2016 ka pasur 7 çështje të filluara kryesisht nga prokurori;

Referimet apo kallzimet per veprat penale jane kryer ne keto perqindje nga subjekte te ndryshme


Viti 2017



Viti 2016




Në një krahasim të viteve 2017 dhe 2016 vihet re si më poshtë në grafik, luhatja e referimeve:




VI. KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Raporti krime dhe kundravajtje


Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2017, sipas ndarjes në krime dhe kundravajtje penale që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.



Ndërkohë për vitin 2016, siç shihet më poshtë rezulton e njëjta përqindje.



Procedime të regjistruara sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2016 – 2017, vijojnë më poshtë:



Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të rregjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, të shprehura në përqindje, **në krahasim të dy viteve është si vijon:**

Në vitin 2016, krime kundër jetës, me dashje ishin rregjistruar 30 materiale, të cilat në përqindjen e numrit total të procedimeve penale të rregjistruara zinin 1%. Në vitin 2017, Krime kundër jetës, me dashje janë rregjistruar 18 procedime penale, në përqindje 1%;

Në të dy vitet, 2016 dhe 2017, nuk ka pasur procedime penale të rregjistruara për krime kundër jetës me pakujdesi .

Në vitin 2016, Vepra penale me dashje kundër shëndetit janë rregjistruar 127 procedime penale të cilat shprehen në përqindje 5 % kurse në vitin 2017, Vepra penale me dashje kundër shëndetit rezultojnë të jenë rregjistruar 115 procedime penale, në përqindje 5 %.

Në vitin 2016 nuk janë rregjistruar vepra penale me pakujdesi kundër shëndetit ndërkohë që në vitin 2017 është rregjistruar 1 procedim penal.

Në vitin 2016, Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës ishin rregjistruar 16 procedime penale që zinin në numrin total të procedimeve penale të rregjistruara vlerën e shprehur në përqindje 1 %. Në vitin 2017, Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës janë rregjistruar 32 procedime penale duke mbetur e pandryshuar raporti në përqindje 1 %;

Në vitin 2016 dhe 2017, procedime penale për Krime seksuale, janë rregjistruar për seilin vit nga 10 procedime penale të tilla, të cilat në zërin e përgjithshëm, zënë 0 %.

Në vitin 2016, Vepra penale kundër lirisë së personit, ishin rregjistruar 4 të tilla të shprehura në përqindje 0%. Në vitin 2017, Vepra penale kundër lirisë së personit janë rregjistruar 3, në përqindje 0%;

Në vitin 2016, Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit ishin rregjistruar 16, në përqindje 1%. Në vitin 2017, Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit janë rregjistruar 15, në përqindje 1%;

Në vitin 2016, Vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes ishin rregjistruar 115, në përqindje 5%. Në vitin 2017, Vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes janë rregjistruar 108, në përqindje 5%;

Në vitin 2016 dhe 2017 nuk ka pasur të rregjistruara procedime penale për Vepra penale kundër lirisë së besimit;

Në vitin 2016, vepra penale në lidhje me Vjedhjen e pasurisë kanë qenë 898, në përqindje 28 %. Në vitin 2017 numri i çështjeve të rregjistruar për Vjedhja e pasurisë ka pësuar rënie në 708, në përqindje 24 %;

Në vitin 2016, veprat penale në lidhje me Mashtrimet kanë qenë të rregjistruara 35, në përqindje 2%. Në vitin 2017, rregjistrimi i çështjeve për këto vepra penale, Mashtrimet, ka pësuar rënie, duke shkuar në 23, në përqindje 1%;

Në vitin 2016, vepra penale që lidhen me Shkatërrimin e pronës janë rregjistruar 109, në përqindje 5 %. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Shkatërrimin e pronës kanë pësuar rritje duke shkuar në 153, në përqindje 6 %;

Në vitin 2016 dhe 2017, Vepra penale në shoqëritë tregtare, ka pasur të rregjistruar nga 1 procedim, në përqindje 0%.

Në vitin 2016 dhe 2017 nuk ka pasur të rregjistruara materiale për Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare;

Në vitin 2016, Krime në fushën e doganave kanë qenë të rregjistruara 7, në përqindje 0%. Në vitin 2017, Krime në fushën e doganave, janë rregjistruar 8, në përqindje 0%;

Në vitin 2016, Vepra penale në fushën e tatim taksave ka pasur të rregjistruara 10, në përqindje 0 %. Në vitin 2017, Vepra penale në fushën e tatim taksave janë rregjistruar 11, në përqindje 0 %;

Në vitin 2016, vepra penale në lidhje me Falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë kanë qenë 9, në përqindje 0%. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë kanë qenë 8, në përqindje 0%;

Në vitin 2016, vepra penale në lidhje me Falsifikimi i dokumentave kanë qenë të rregjistruara 60, në përqindje 3%. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Falsifikimi i dokumentave janë rregjistruar 72, në përqindje 3%;

Si në vitin 2016 ashtu edhe në vitin 2017, nuk ka pasur të rregjistruara Vepra penale në fushën e falimentit;

Në vitin 2016, vepra penale në lidhje me Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit, kanë qenë 32, në përqindje 1 %. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit janë rregjistruar më pak, konkretisht 11, në përqindje 0 %;

Në vitin 2016, Vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës kanë qenë të rregjistruara 151, në përqindje 6 %. Në vitin 2017, Vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës kanë pësuar rritje, duke u rregjistruar 233, në përqindje 9 %;

Në vitin 2016 Vepra penale kundër mjedisit ishin rregjistruar 27, në përqindje 1 %. Në vitin 2017, ka pasur një rritje të këtyre veprave penale, Vepra penale kundër mjedisit, duke u rregjistruar 40, në përqindje 2 %;

Si në vitin 2016 ashtu edhe në vitin 2017, vepra penale të parashikuara në Kreu V – VI dhe Akte terroriste, nuk rezulton të jetë rregjistruar ndonjë çështje.

Në vitin 2016, Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga shtetasit kanë qenë të rregjistruara 49, në përqindje 2 %. Në vitin 2017, ka pësuar një rritje të këtyre Veprave penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga shtetasit duke u rregjistruar 60, në përqindje 3 %;

Në vitin 2016, Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga punonjësit kanë qenë të rregjistruara 90, në përqindje 4 %. Në vitin 2017, ka pasur një rënie të Veprave penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga punonjësit, duke u rregjistruar 56, në përqindje 2 %;

Në vitin 2016, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike kanë qenë të rregjistruara 424, në përqindje 16 %. Në vitin 2017, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë rregjistruar 436, në përqindje 16 %;

Në vitin 2016, ka pasur 1 vepër penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore ndërkohë që në vitin 2017, kjo shifër është zero;

Në vitin 2016, Vepra penale kundër drejtësisë kanë qenë të rregjistruara 71, në përqindje 3 %. Në vitin 2017, kanë pësuar një rritje Veprat penale kundër drejtësisë, duke u rregjistruar 139, në përqindje 6 %;


Në vitin 2016, Vepra penale që çënojnë zgjedhjet e lira nuk ka pasur të rregjistruara ndërkohë që në vitin 2017 janë rregjistruar 10 të tilla, në përqindje 0%;

Si në vitin 2016 ashtu edhe në vitin 2017, nuk ka pasur të rregjistruara vepra penale në lidhje me bandat e armatosura.


VII. TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË

Gjatë vitit 2017, nga Prokurorët e Prokurorisë Elbasan janë lëshuar 2251 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale, nga të cilët rezultojnë të jenë ekzekutuar 1566 dhe të kenë mbetur pa u ekzekutuar 685 urdhëra ekzekutimi.


Gjatë vitit 2016, nga Prokurorët e Prokurorisë Elbasan janë lëshuar 2694 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale, nga të cilët rezultojnë të jenë ekzekutuar 1792 dhe të kenë mbetur pa u ekzekutuar 902 urdhëra ekzekutimi.




Në grafik urdhërat e ekzekutimit të lëshuar nga kjo prokurori, për vitin 2017, sipas zërave të veçantë, paraqiten në këtë mënyrë:




Në grafik urdhërat e ekzekutimit të lëshuar nga kjo prokurori, për vitin 2016, sipas zërave të veçantë, paraqiten në këtë mënyrë:



Referuar llojit të dënimit, në mënyrë grafike, në përqindje paraqiten urdhërat e ekzekutimit për vitin 2017:



Referuar llojit të dënimit, në mënyrë grafike, në përqindje paraqiten urdhërat e ekzekutimit për vitin 2016:



Në shifra konkrete, urdhërat e ekzekutimit të lëshuar nga kjo prokurori, janë të evidentuar si më poshtë:

- 352 urdhera ekzekutimi me burgim,
- 179 urdhera ekzekutimi me gjobe,
- 3 urdhera per denim plotesues,
- 403 urdhera ekzekutimi per denimet me kusht,
- 84 urdhera per denimet me pune në interes publik,
- 898 urdhera ekzekutimi per shpenzimet proceduriale,


- 253 urdhera ekzekutimi per provat materiale,
- 2 urdhera per pushim ceshtje penale,
- 14 urdhera ekzekutimi per masat mjekesore te mjekimit te detyruar,
- 3 urdhera ekzekutimi per konvertim denimi me gjobe ne denim me burg,
- 3 urdhera per revokimin e denimeve me kusht,
- 11 urdhera per njohje paraburgimi per te denuarit qe jane ekstraduar,
- 10 urdhera ekzekutimi per bashkim denimi,
- 9 urdhera ekzekutimi per te denuarit qe kane perfituar me vendim gjykate nga ligji per perfitim amnistie,
- 5 urdhera ekzekutimi per saktesimin te vuajtjes se denimit,
- 4 urdhera per shtyrje ekzekutim te vendimit te denimit
- 4 ndryshimi i llojit të sigurisë së vuajtjes së dënimit;
- dhe disa urdhera te tjera per vendime te dhena nga gjykata.

Nga 2251 urdherat e ekzekutimit te nxjerra, jane ekzekutuar 1566 urdhera ekzekutimi:

- 340 urdhera per veprat penale per denim me burgim,
- 30 urdhera per denimin me gjobe,
- 3 urdhera per denim plotesues,
- 403 urdhera ekzekutimi per denimet me kusht dhe me pune publike,
- 84 urdhera per provat materiale dhe disa urdhera per vendime te tjera te dhena nga gjykata.
- 403 urdhera ekzekutimi per shpenzimet proceduriale per vendimet e gjykates te dhene gjate vitit 2017,
- 124 urdhera ekzekutimi per shpenzimet proceduriale te vitit 2016,

- 37 urdhera ekzekutimi per shpenzimet procedurale te vitit 2015
- 1 urdher ekzekutimi per shpenzimet procedurale te vitit 2014 .

Kane mbetur pa u ekzekutuar 685 urdhera ekzekutimi të cilat sipas zërave ndahen në përqindje si më poshtë:



45 urdhera ekzekutimi me burgim,

149 urdhera ekzekutimi me gjobe,

491 urdhera ekzekutimi per shpenzimet procedurale dhe disa urdhera ekzekutimi qe jane nxjere gjate ketij viti.

VIII. ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Krime kundër jetës të kryera me dashje


KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj. ³	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja ⁴	2	2	1	2	0	3	0	2	0	3
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	1	1	1	2	0	2	0	0	0	1
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 80	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 81 Vrasja e foshnjës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	0	2	0	2	2	0	0	0	0	0
Neni 83/a Kanosje për	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0

³ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.



⁴Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (Per vitin 2017 numri i procedimeve per n. 76 - 22 i K.Penal, te cilat jane 5 çeshtje, 7 pandehur, numri i procedimeve te derguara per gjykim qe jane 2 dhe numri i te pandehurve derguar gjyqit 3 si dhe 4 të denuar. Nderkohe per vitin 2016 nuk jane shenuar numri i procedimeve per n. 76 - 22 të K.Penal që janë 3, numri i te pandehurve te rregjistruar qe eshte 3, numri i ceshtjeve te derguara per gjykim qe eshte 5, numri i te pandehurve derguar per gjykim qe eshte 5 dhe numri i te denuarve per vitin 2016 qe eshte 3).

hakmarrje/ gjakmarrje


Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84 Kanosja	9	1	4	1	0	19	5	8	5	6
Totali	13	6	6	7	2	27	5	10	5	10





Të pandehur gjithsej referuar vendimeve gjyqësore, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar si dhe të dëmtuarit, për dispozitat 76 – 84 të K.Penal:




Raporti i vdekjeve:





Raporti femra meshkuj, raporti te mitur e te rritur, per te pandehurit, per vitin 2017 dhe 2016, referuar vendimeve gjyqësore, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, për dispozitat 76 – 84 të K.Penal:





Raporti femra, meshkuj, të rritur e të mitur, për të dëmtuarit, në të dy vitet:




Arsimim, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:



Vendbanimi, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:




Gjendja gjyqesore, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:





KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand. per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 86 Tortura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 87 Tortura me pasoja te renda	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88 Plagosje e rende me dashje	9	8	8	11	10	9	5	8	6	2
Neni 88/a Plagosje e rende ne gjendje te tronditjes se forte psikike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88/b Plagosje e rende me kapercim te kufijve te mbrojtjes se nevojshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 89 Plagosje e lehte me dashje	106	40	84	42	20	117	47	88	68	46
Neni 89/a Shitblerja e	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0



transplanteve										
Neni 90 Demtime te tjera me dashje	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Totali	115	48	92	53	30	127	52	96	74	48





Të pandehur gjithsej referuar vendimeve gjyqësore, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar si dhe të dëmtuarit, për dispozitat 86-90 të K.Penal:




Raporti plagosje e lehte dhe plagosje rëndë tek te demtuarit:





Raporti femra meshkuj, raporti te mitur e te rritur, per te pandehurit, per vitin 2017 dhe 2016, referuar vendimeve gjyqësore, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, për dispozitat 86-90 të K.Penal:





Raporti femra, meshkuj, të rritur e të mitur, për dy vitet:





Arsimim, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:



Vendbanimi, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:




Gjendja gjyqesore, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:




VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	3	2	0	4	1	5	0	0	0	0
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	28	0	0	0	0	10	0	0	0	1
Totali	32	2	0	4	1	16	0	0	0	1





Të pandehur gjithsej referuar vendimeve gjyqësore, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar si dhe të dëmtuarit, për dispozitat 93 - 99 të K.Penal:





Në vitin 2016, janë raportuar 10 të dëmtuar/viktima, konkretisht 1 femër e mitur, 6 meshkuj të rritur dhe 3 femra të rritura. Janë raportuar në vitin 2016, edhe 8 vdekje. Në vitin 2017, nuk ka raportime për të dëmtuarit.



Raporti femra meshkuj, raporti te mitur e te rritur, per te pandehurit, per vitin 2017 dhe 2016, referuar vendimeve gjyqësore, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, për dispozitat 93-99 të K.Penal:





Arsimim, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:



Vendbanimi, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:




Gjendja gjyqesore, per vitin 2017 dhe 2016 per te pandehurit:





	2017					2016				
KRIME SEKSUALE	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	4	3	2	3	1	2	0	2	0	2
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura	3	0	1	0	1	3	2	2	2	1
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
